# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-428726**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Bajram Begaj dekreton shkarkimin e Evis Salës, Klodiana Spahiu emërohet ministre e Shëndetësisë – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/bajram-begaj-dekreton-shkarkimin-e-evis-sales-klodiana-spahi-emerohet-ministre-e-shendetesise/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 8 shtator 2026, 16:48:51 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 8 shtator 2026, 07:04:07 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `0ed2f0ea7e7cde0a994f8af037b8a954f0670a985c261328a9b176b94257b32f` |
| TEKSTI | `a7e7c67449a9babbdb8c62e7871545a808cc0a82c81ee0b54173bf95f98e9b1d` |
| PAMJA | `3ed59ff762aac34407c2fee9cb663b15fe6f8822256a203a21b978eb3232c554` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `fa1963f6140e1af836dc34f3745e6f4628baa422147ac130cdc0b664418d1967` |
| E MËPARSHMJA | `ea7d3a63a41872c57d3e938d6fe46daa0149cd37e17a37457e0334c9354d4a71` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/fa1963f6140e1af836dc34f3745e6f4628baa422147ac130cdc0b664418d1967`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Presidenti i Republikës, Bajram Begaj, ka dekretuar sot shkarkimin e Evis Salës nga detyra e Ministres së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Në të njëjtën ditë, Presidenti Begaj ka dekretuar emërimin e Klodiana Spahiut në detyrën e Ministres së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**PRESIDENTI**

**D E K R E T**

**PËR SHKARKIM MINISTRI**

Në mbështetje të nenit 93 dhe nenit 98, pika 1 të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

**D E K R E T O J:**

**Neni 1**

Zonja Evis Sala, Ministër i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, shkarkohet nga kjo detyrë.

**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

5 Elbasani nuk fal! Egnatia pëson humbjen e parë të sezonit

NEWSLETTER
**Përmbledhja e ditës në e-mail**
emaili juaj
Abonohu

**Dekret nr. 490**

**Tiranë, më 8.9.2026**

**PRESIDENT I REPUBLIKËS**

**BAJRAM BEGAJ**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË PRESIDENTI

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**PRESIDENTI**

**D E K R E T**

**PËR EMËRIM MINISTRI**

Në mbështetje të nenit 93 dhe nenit 98, pika 1 të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

**D E K R E T O J:**

**Neni 1**

Zonja Klodiana Spahiu emërohet Ministër i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**Dekret nr. 491**

**Tiranë, më 8.9.2026**

**PRESIDENT I REPUBLIKËS**

**BAJRAM BEGAJ**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË PRESIDENTI

Evis Sala dha dorëheqjen nga detyra më 2 shtator. Sala kishte marrë drejtimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale më 11 shtator 2025, pas prezantimit të qeverisë "Rama 4" nga kryeministri Edi Rama.

Një ditë pas dorëheqjes së Salës, kryeministri i vendit Edi Rama propozoi për detyrën e Ministres së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale Klodiana Spahiun.

Klodiana Spahiu ka përfunduar studimet në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Mjekësisë, dega "Mjekësi e Përgjithshme" në vitin 1997. Më pas,

në vitin 1998-2002 është specializuar në fushën e kardiologjisë, në po të njëjtin departament pranë QSUT-së "Nënë Tereza", në Tiranë.

Ajo ka kryer një sërë specializimesh ndër vite, si në fushën e kardiologjisë joinvazive: ekokardiografi, PU-EKG, eko-doppler e karotideve, pranë Universitetit Katolik: "Sacro Cuore", Facolta di Medicina e Chirurgia "Agostino Gemeli", Romë, Itali.

Në 2003-2004 kreu studimet pasuniversitare pranë Fakultetit të Mjekësisë, Departamenti i Lëndëve Paraklinike. Gjatë periudhës tetor 2005 – dhjetor 2005 ka kryer specializim në fushën e kardiologjisë invazive, kateterizimi i zemrës dhe koronarografinë e zemrës, pranë spitalit "Santa Chiara", Pisa, Itali.

Vite me vonë, 2012-2014 ajo ka përfunduar edhe masterin profesional "për menaxhimin shëndetësor"

Spahiu ka ushtruar profesionin e mjekut në klinikën e parë të kardiologjisë në QSUT.

Gjithashtu, ajo ka punuar si mjeke kardiologe dhe në repartin e patologjisë në spitalin e Durrësit gjatë viteve 2003-2009. Më pas është zgjedhur dhe drejtoreshë e këtij spitali.
Ajo ka një përvojë të gjatë edhe në fushën e pedagogjisë. Në vitin 2002-2003 ka qenë pedagoge në Departamentin e Lëndëve Paraklinike, Universiteti i Tiranës dhe në 2006 ka qenë pedagoge e jashtme në lëndën e fiziologjisë në Universitetin "UFO", Tiranë.

Viti 2008 dhe në vazhdim – Docente në praktikat e kardiologjisë pranë Universitetit "Zonja e Këshillit të Mirë", Tiranë. Ajo mban titullin "Doktore e Shkencave Mjekësore".

#BEgaj #evissala

**Xhuljana Zhuleku**
Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

## Vazhdo të lexosh



VENDI
**"Smart City", Kumbaro: Kamerat...**
Xhuljana Zhuleku 3 minuta më parë



VENDI
**Nis shkolla, Kumbaro prezanton risitë në...**
Xhuljana Zhuleku 15 minuta më parë

VENDI
**Nis sezoni i ri shkollor, 680 nxënës më pak...**
Xhuljana Zhuleku 1 orë më parë




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.